



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1740/2 prot

Datë 01.07.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË TJERË

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorëve ekonomikë “GENERAL PLUS” SHPK, “Biotek” SHPK dhe “ALMA KODRA” PF, për procedurën e prokurimit “*Procedure e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-06297-05-23-2024, me objekt: “*Blerje rrota për kazane*”, me fond limit 1.702.800 (një milion e shtatëqind e dy mijë e tetëqind) lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 18.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Eco Tirana sha.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Bajro Bross” SHPK me NIPT M113130290 dhe me adresë Rr. Ndre Mjeda, Kompleksi rezidencial “Magnet”, Pallati Lura, njësi shërbimi nr.1017, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Eco Tirana sha me adresë Tiranë, Rruga Don Bosko ish parku i autobusave.
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “GENERAL PLUS” SHPK me NIPT L82020015J dhe me adresë Tiranë, Njësia Bashkiake nr.5, “Komuna e Parisit”, Pallati 6, Shkalla 2, apartamenti 25.
- Operatori ekonomik “Biotek” SHPK me NIPT L82203011N dhe me adresë Rr. Bashkimi, Nd 3, H1, Vlorë.

Operatori ekonomik “ALMA KODRA” PF me NIPT
K32725211G dhe me adresë Elbasan, L.HAXHIAS.

Në datën 28.06.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4266, si dhe nr. protokoli 1740/2024 datë 28.06.2024 e Operatorit ekonomik “GENERAL PLUS” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedure e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-06297-05-23-2024, me objekt: “**Blerje rrota për kazane**”, me fond limit 1.702.800 (një milion e shtatëqind e dy mijë e tetëqind) lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 18.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Eco Tirana sha.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë ofertues “GENERAL PLUS” SHPK, “Biotek” SHPK dhe “ALMA KODRA” PF, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.*”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues, pretendon se nuk përmbushen nga operatorëve ekonomikë ofertues “GENERAL PLUS” SHPK, “Biotek” SHPK dhe “ALMA KODRA” PF, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik ofertues “GENERAL PLUS” SHPK, të kriterëve si më poshtë:

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për produktet e ofruara ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose distributorit të autorizuar. Në rast se një autorizim paraqitet nga distributori i autorizuar, lidhja, bashkëpunimi i kontratës / furnizimit, ndërmjet distributorit të autorizuar dhe prodhuesit duhet të jetë e paraqitur me dokumentacionin përkatës.

2.4.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë moster për çdo artikull sipas specifikimeve teknike të cilesuara nga autoriteti kontraktor në ditën dhe orën e hapjes së ofertave.

Mostrat e kërkuara për secilin produkt, duhet të paraqiten në një kuti të mbyllur, me etiketë të dallueshme ku të vendosen të dhënat si më poshtë:

moster “emri për secilin artikull” datën e zhvillimit të tenderit, emrin e prodhuesit/ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik, të cilat do mbahen nga Autoriteti Kontraktor sipas rregullores. Mostrat e paraqitura duhet të perputhen me specifikimet teknike sipas Shtojces 5 dhe 6. Mosparaqitja ose mosperputhja e mostrave është kusht s’kualifikimi. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim”.

Gjithashtu: Përpara shpalljes përfundimtare të njoftimit të fituesit, OE -GENERAL PLUS, duhet të dorëzonte pranë AK, përveç dokumentacionit të dorëzuar në SPE edhe dokumentat e mëposhtme provuese të deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit, në origjinal ose të njehësuar me origjinalin:

A-.Në përputhje me pikën A të Pjesës II shkaqet e përjashtimit:

*1-. Ekstraktin e thjeshte dhe historik te Regjistrit tregetar - paragrafi i pare dhe paragrafi i peste.
2- Vertetim nga gjykata per ceshtjet penale per subjektin, administratorin, ortaket dhe aksioneretn paragrafi i dyte.*

3- Vertetim nga prokuroria per ceshtjet penale per subjektin, administratorin dhe ortaket dhe aksioneretn paragrafi dyte dhe i trete.

4- Vertetim i gjendjes gjyqesore per subjektin nga DPB ose e -albania.

5- Vertetim i gjendjes gjyqesore per administratorin, ortaket dhe aksioneret, nga e-albania

6- Vertetim nga gjykata per ceshtjet civile per subjektin paragrafi i katert.

7- Vertetim nga tatimet per pagesen e tatimeve dhe sigurimeve - paragrafi i gjashte.

8- Vertetim per detyrimet e energjise elektrike (pershire muajin prill 2024), nga FSHU - paragrafi i shtate. B- Ne perputhje me piken B te Pjeses IIIV n Kriteret e kualifikimit:

9- Vertetim per numrin e punonjesve te deklaruar (nqs ka deklaruar qe disponon punonjes), kontratat perkatese te punonjesve te deklaruar.

10- Dokumentacionin e mjeteve te deklaruar (nqs ka deklaruar qe disponon mjete).

Nepermjet kesaj ankese, kerkojme Skualifikimin e OE GENERAL PLUS.

Kërkojmë refuzimin e ofertave të këtyre dy OE si dhe shtimin e arsyeve të refuzimit, pasi OE-Biotek dhe OE -ALMA KODRA, përveç se nuk plotësojnë pikën 2.4.4 të kërkesave për kualifikim të DT, gjithashtu nuk plotësojnë pikën 2.4.1 të kërkesave për kualifikim të DT. Kërkojmë skualifikimin e OE – Biotek shpk dhe OE - ALMA KODRA PF.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 01.07.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Gjergj Mersini

Kryetar

Jonaid Myzyri